



VENDIM

Nr.68 Date 13.09.2010

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE
VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË ALB WID ENERGY
SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2010, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë Alb Wind Energy sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qënë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik përveç vonesave administrative në të cilat ka kaluar, ka pësuar edhe dëmtime gjatë këtij viti,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr. 81, date 04.11.2009 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve te vendosura nga ERE shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k,
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA

Adresa: Rruga "Gjergj Fishta" 10
963
Tirane
69 590
E-mail: erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al